



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

**R A P O R T**

**PËR DEKRETIN NR.6975, DATË 12.4.2011 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR  
KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR.10404, DATË 24.3.2011 “PËR DISA  
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002 “PËR AKCIZAT  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 prill 2011, shqyrtoi dekretin nr.6975, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.10404, datë 24.3.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar.

Ministri i Financave u paraqit ne Komision per te mbrojtur ligjin per akcizat nr.10404, datë 24.3.2011, si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Në dekretin e Presidentit të Republikës kërkohet kthimi për rishqyrtim në Kuvend i ligjit nr.10404, datë 24.3.2011, për shkak se ai bie ndesh me ligjin nr.9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”. Sipas nenit 33 të saj, *“që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njejtë me to dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë“.*

Në dekret theksohet se ligji për akcizat ndryshon tarifat e përcaktuara para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke sjellë mosrespektimin e parimit të sistemit ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut dhe diskriminimin e prodhuesit vendas. Për këto arsye, dekreti kërkon përmirësimin e këtij akti ligjor gjatë shqyrtimit nga Kuvendi.

Ministri i Financave argumentoi se vendosja e pullave fiskale për mallrat e akcizës, të përcaktuara në këtë ligj, nuk bie ndesh me nenit 33 të MSA-së, pasi:

- Ligji nr.8449, datë 27.1.2011 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë“ jep përkufizimin e detyrimeve të importit dhe detyrimeve të eksportit. Me “detyrime importi”

kuptohen taksat doganore dhe taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore, të cilat duhen paguar në importimin e mallrave. Me “detyrime eskporti” kuptohen taksat doganore dhe taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore, të cilat duhen paguar në eksportimin e mallrave.

Përcaktimi i termit “taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore” është bërë nëpërmjet Vendimit të Gjykatës Europiane të Drejtësisë të datës 1 korrik 1969. Në këtë vendim theksohet: *“çdo detyrim fiskal, sado i vogël që të jetë dhe çfarëdo qoftë mënyra e tij e zbatimit dhe kushdo qoftë qëllimi i tij, i cili vendoset në mënyrë të njëanshme mbi mallra të brendshëm ose të huaj, për arsyen se ato kalojnë kufirin dhe që nuk është një detyrim doganor në një kuptim strikt, përbën detyrim me efekt të njëjtë... edhe në rastin se është vendosur për pëfitimin e shtetit apo nuk është diskriminues apo mbrojtës në efektet e tij dhe produkti mbi të cilin ai zbatohet nuk konkurren produktin vendas”*.

Nga ky përkufizim rrjedh se pullat fiskale nuk përbëjnë taksa me efekt të njëjtë me detyrimet doganore, në kuptim të nenit 33 të MSA-së, pasi ato vendosen si për importuesit, ashtu edhe për prodhuesit. Kostoja e tyre nuk është diskriminuese ndaj prodhimit vendas, sepse ato u shiten me çmim të njëjtë si prodhuesve vendas, ashtu edhe importuesve.

- Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar masat me efekt të njëjtë me detyrimet doganore të cilat janë licencat e importeve, paraqitja e detyruar e disa certifikatave, inspektimi dhe kontrolli veterinar, gjobat dhe sanksionet, kushtet dhe kreditë për pagesat, detyrimi për të patur një përfaqësues në territorin e një vendi anëtar, rregullat e brendshme ose kontrolli i çmimit, rimbursimi i produkteve farmaceutike etj.
- Në Direktivën 218, datë 16 dhjetor 2008 janë përcaktuar modalitetet e përgjithshme lidhur me taksën e akcizës, që vendoset direkt ose indirekt mbi konsumin e mallrave të akcizës. Në nenin 15 të saj theksohet se *“çdo shtet anëtar përcakton rregullat e veta lidhur me prodhimin, përpunimin dhe mbajtjen e mallrave të akcizës, që janë subjekt i kësaj Direktive”*.
- Në nenin 39 të po kësaj direktive përcaktohet se *“shtetet anëtare mund të kërkojnë që mallrat e akcizës të mbajnë pulla fiskale ose shenja dalluese kombëtare, të përdorura për qëllime fiskale... kur ato hyjnë në territorin e tyre”*.

Bazuar në referencat e mësipërme, rrjedh se legjislacioni i BE-së lejon përdorimin e pullave fiskale për të miradministruar vjeljen e akcizës.

Ndryshimet në ligjin për akcizat vijnë si pasojë e hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale, e cila është dekretuar pa asnjë kontestim. Ky ligj ka qenë objekt diskutimi me BE-në dhe nuk ka patur kontestime për shkelje të MSA-së.

Komisioni në diskutimet e tij mbështeti argumentat ligjore të paraqitura dhe është i mendimit se ligji nr.10404, datë 24.3.2011 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë“ është në përputhje me MSA-në. Ky ligj nuk passjell diskriminim të prodhimit vendas, pasi vendos të njejtat rregulla të administrimit dhe të vjeljes së akzicës si për prodhimet vendase, ashtu edhe për ato të importit.

Për këto arsye, Komisioni nuk e miratoi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje dekretin nr.6975, datë 12.4.2011 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.10404, datë 24.3.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar.

**RELATORI**

**Edmond SPAHO**



**KRYETARI**

**Edmond SPAHO**



Tiranë, më 21.4.2011